



23 MARS 2020

Masat e marra në kuadër të Pandemisë COVID-19 nga Autoritetet Shqiptare

Për shkak të përhapjes së virusit COVID-19 Autoritetet Shqiptare kanë marrë një sërë masash për të parandaluar përhapjen e tij. Më poshtë janë të listuar të gjitha masat e ndërmarra deri më datë 23 Mars 2020.

Përmbajtja

ORARET E LËVIZJES DHE ZHVILLIMIT TË AKTIVITETEVE.....	1
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE	1
PLANI FINANCIAR	7

ORARET E LËVIZJES DHE ZHVILLIMIT TË AKTIVITETEVE

Autoritetet Shqiptare kanë njoftuar se do të ndryshojë orari i lejuar për lëvizjen e individëve si dhe orari i aktivitetit të subjekteve (pikat e shitjes së ushqimeve, farmacitë, shërbimet bankare, administrata shtetërore). Duke nisur nga e Hëna datë 23 Mars 2020 orari i lejuar do të jetë 05:00 – 13:00.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka publikuar listën e aktiviteteve që do të lejohen apo do të ndalohen të ushtrojnë aktivitet ekonomik. Duke filluar nga data 24 Mars 2020:

Do të lejohen:

Të vazhdojnë ushtrimin e aktivitetit të gjithë tatimpaguesit që kryejnë aktivitet në fushën e prodhimit bimor dhe shtazor, përpunimin e produkteve ushqimore, prodhimeve të drurit, prodhimit të tekstilëve, prodhimit të produkteve kimike, produkteve farmaceutike, prodhimit të mineraleve, prodhimi i produkteve elektronike, prodhimi i produkteve elektrike, prodhimi i mobilieve, prodhimi i energjisë, prodhimi dhe furnizimi me ujë, si dhe shërbimet e pastrimit, ndërtimit të ndërtesave, punimeve inxhinierike etj., të përcaktuara në tabelën më poshtë të cilat kanë statusin “Lejohen”.



Kodi NVE	Përshkrimi i aktivitetit	Statusi i Aktivitetit
1	Prodhimi bimor dhe shtazor, gjuetia dhe shërbime të lidhura me to	Lejohen
2	Pyjet dhe shfrytëzimi i pyjeve	Lejohen
3	Peshkimi dhe Akuakultura	Lejohen
5	Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve	Lejohen
6	Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror	Lejohen
7	Nxjerrja e mineraleve metalore	Lejohen
8	Nxjerrje të mineraleve të tjera nga minierat	Lejohen
9	Aktivitete mbështetëse minerare	Lejohen
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	Lejohen
11	Prodhimi i pijeve	Lejohen
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	Lejohen
13	Përpunimi i tekstileve	Lejohen
14	Konfeksionimi i veshjeve	Lejohen
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	Lejohen
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobilieve	Lejohen
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre	Lejohen
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	Lejohen
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	Lejohen
20	Prodhimin e kimikateve dhe produkteve kimike	Lejohen
21	Përpunimi i produkteve farmaceutike dhe preparateve farmaceutike	Lejohen
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	Lejohen
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalikë	Lejohen
24	Metalurgjia	Lejohen
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	Lejohen
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	Lejohen
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	Lejohen
28	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve	Lejohen
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysëmrimorkiove	Lejohen
30	Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit	Lejohen
31	Prodhimi i mobilieve	Lejohen
32	Industri të tjera	Lejohen
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	Lejohen
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	Lejohen
36	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	Lejohen
37	Kanalizimet	Lejohen



38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	Lejohen
39	Shërbime të tjera të pastrimit e të menaxhimit të mbetjeve	Lejohen
41	Ndërtimi i ndërtesave	Lejohen
42	Punime inxhinjerie	Lejohen
43	Punime të specializuara ndërtimi	Lejohen
45	Tregtia me shumicë dhe pakicë i automjeteve, moto mjeteve, ciklomotorëve dhe riparimi I tyre	Lejohen
47	Tregtia me shumicë, përveç automjeteve, moto mjeteve dhe ciklomotorëve	Lejohen
48	Tregtia me pakicë, përveç tregtisë së automjeteve, moto mjeteve dhe ciklomotorëve	Lejohen
49	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara me një mbizotërim të ushqimit dhe pijeve	Lejohen
51	Tregtia me pakicë në dyqanet kompjuterike jo të specializuara, Pajisjet Telekomunikuese, Elektronikë e Konsumatorit	Lejohen
53	Shitje me pakicë e produkteve të ushqimit, pijeve dhe duhanit në njësi të specializuara	Lejohen
54	Shitje me pakicë e karburantit për automjete	Lejohen
55	Shitje me pakicë e pajisjeve kompjuterike dhe për telekomunikacionin (TIK)	Lejohen
57	Shitja me pakicë e pajisjeve fizike, ngjyra, xhami të sheshtë dhe materialeve ndërtimore	Lejohen
58	Shitje me pakicë e sendeve higjieno-sanitare	Lejohen
60	Shitje me pakicë e makinerive, pajisjeve dhe produkteve për bujqësinë; Makineritë dhe pajisjet për kopshtarinë	Lejohen
64	Shitje me pakicë e artikujve të ndriçimit	Lejohen
69	Tregtia me pakicë e Gazetave, Revistave dhe Periodikëve	Lejohen
76	Tregtia me pakicë e ilaçeve në dyqane të specializuara	Lejohen
77	Tregtia me pakicë në artikuj mjekësorë dhe ortopedikë në njësi të specializuara	Lejohen
78	Shitje me pakicë e artikujve të parfumerive, tualeteve dhe produkteve të higjienës personale	Lejohen
79	Mjeket popullore/mjekimet	Lejohen
84	Shitje me pakicë e materialeve të optikës dhe pajisjeve fotografike	Lejohen
86	Shitje me pakicë të karburantit shtëpiak dhe për ngrohje	Lejohen
88	Shitje me pakicë e sapunëve, pastruesve, produktet e ngjashme	Lejohen
91	Ambulantët	Lejohen
92	Biznes me pakicë me postë ose internet	Lejohen



94	Tregtia e bërë nga makineritë e shitjes automatike	Lejohen
95	Transporti tokësor I mallrave dhe me tubacione	Lejohen
96	Transporti ujor I mallrave	Lejohen
97	Transporti ajror I mallrave	Lejohen
98	Magazinimi dhe aktivitete mbështetëse për transportin	Lejohen
99	Aktivitete të postës dhe korrierit	Lejohen
100	Hoteleri/struktura akomoduese	Lejohen
102	Aktivitete publikimi	Lejohen
103	Filma, video dhe prodhimi i programeve televizivë, regjistrimi i zërit dhe aktivitete publikimi të muzikës	Lejohen
104	Aktivitete të programimit dhe shpërndarjes	Lejohen
105	Telekomunikacioni	Lejohen
106	Shërbime të teknologjisë së informacionit	Lejohen
107	Aktivitete të shërbimit të informacionit	Lejohen
108	Aktivitete të shërbimeve financiare, përveç sigurimeve dhe financimit të pensioneve	Lejohen
109	Sigurimi, ri sigurimi dhe financimi i fondeve të pensioneve, përjashtuar sigurimin shoqëror të detyrueshëm	Lejohen
110	Aktivitete të tjera financiare	Lejohen
111	Aktivitete të pasurive të paluajtshme	Lejohen
112	Aktivitete juridike dhe të kontabilitetit	Lejohen
113	Aktivitete të drejtimit të ndërmarrjeve dhe aktivitete të konsultimit	Lejohen
114	Aktivitete arkitekture dhe inxhinjerie; aktivitete të kontrolleve dhe analizave teknike	Lejohen
115	Kërkim dhe zhvillim shkencor	Lejohen
116	Publiciteti dhe kërkimet e tregut	Lejohen
117	Aktivitete të tjera profesionale, shkencore dhe teknike	Lejohen
118	Aktivitete Veterinare	Lejohen
119	Aktivitete të marrjes e dhënies me qira	Lejohen
120	Aktivitete të punësimit	Lejohen
121	Agjenci udhëtimi, operator turistik dhe të tjera aktivitete të shërbimit të rezervimit	Lejohen
122	Aktivitete të sigurimit dhe të hetimit	Lejohen
123	Shërbime ndaj ndërtesave dhe shesheve	Lejohen
124	Administrim zyrash, mbështetje administrative dhe të tjera aktivitete mbështetëse të ndërmarrjeve	Lejohen
125	Administrimi publik dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm	Lejohen
127	Aktivitete të shëndetit	Lejohen
128	Qendra të kujdesit mjekësor	Lejohen
129	Aktivitete të kujdesit social pa akomodim	Lejohen



134	Aktivitetet e shoqatave e organizatave (me përjashtim të mbledhjeve, tubimeve etj.)	Lejohen
135	Riparimi i kompjuterëve dhe artikujve personale dhe familjarë	Lejohen
137	Aktivitete të familjeve si punëdhënës të personelit shtëpiak	Lejohen
138	Aktivitete të prodhimit të mallrave e shërbimeve të pandryshueshme të familjeve për përdorim të vet	Lejohen
139	Aktivitete të organizatave dhe organizmave ndërkombëtare	Lejohen
140	Agjencitë funebre	Lejohen

Nuk do të lejohet:

Ushtrimi i aktiviteteve të njëjësive të shitjeve të përcaktuara në tabelën më poshtë të cilat kanë statusin “Mbyllen”

Ndalohet ushtrimi i aktiviteteve në ambiente që ofrojnë shërbime, lokale nate, ambiente të mbyllura të dedikuara për argëtimin e fëmijëve dhe të rinjve, aktivitete palestra, qendra sportive, pishina, qendra interneti, qendra kulturore dhe qendra argëtimi, të njëjësive të shitjeve në të gjitha Qendrat Tregtare si dhe çdo njësi tjetër që kryhen shitje me pakice të artikujve: industrial, kulturor, veshjeve të llojeve të ndryshme, mallrave artistike, sportive dhe kozmetike.

Kodi NVE	Përshkrimi i aktivitetit	Statusi i Aktivitetit
46	Gomisteri	Mbyllen
50	Qendrat tregtare	Mbyllen
52	Dyqane të tjera jo të specializuara të produkteve të ndryshme jo-ushqimore	Mbyllen
56	Shitje me pakicë e produkteve të tekstit në dyqane të specializuara	Mbyllen
59	Shitje me pakicë e materialeve të ndërtimit, qeramikës dhe pllaka	Mbyllen
61	Shitja me pakicë e Qilimave, Qilimave të Brezit dhe tapiceri Për Dyshemetë dhe Muret (Qilim, Linoleum) në njësi të specializuara	Mbyllen
62	Shitje me pakicë e pajisjeve shtëpiake në dyqane të specializuara	Mbyllen
63	Shitje me pakicë e mjeteve shtëpiake, qelq dhe qeramika	Mbyllen



65	Shitje me pakicë e makinave qepëse për përdorim shtëpiak	Mbyllen
66	Shitje me pakicë e sistemeve të sigurisë	Mbyllen
67	Tregtia me pakicë e instrumenteve muzikorë	Mbyllen
68	Tregtia me pakicë e librave në dyqane të specializuara	Mbyllen
70	Shitje me pakicë për kancelari dhe pajisjeve të zyrës	Mbyllen
71	Tregtia me pakicë e muzikës dhe regjistrimeve video në një studio të specializuar	Mbyllen
72	Shitje me pakicë e mallrave sportive në dyqane të specializuara	Mbyllen
73	Shitje me pakicë e lojërave dhe lodrave në dyqane të specializuara	Mbyllen
74	Shitje me pakicë e artikujve të veshjeve	Mbyllen
75	Shitje me pakicë e këpucëve dhe mallrave prej lëkure	Mbyllen
80	Tregtia me pakicë në lule dhe bimë	Mbyllen
81	Shitje me pakicë e kafshëve shtëpiake të vogla	Mbyllen
82	Tregti me pakicë e orëve, bizhuterive dhe sendeve me vlere	Mbyllen
83	Mobilje për zyre me pakicë	Mbyllen
85	Tregtia me pakicë në objektet e artit dhe të dekorimit	Mbyllen
87	Tregtia me pakicë në armët dhe municionet, artikujt ushtarak	Mbyllen
89	Shitje me pakicë e produkteve të tjera jo-ushqimore	Mbyllen
90	Shitje me pakicë të artikujve të dorës së dytë në dyqane	Mbyllen
93	Shitje me pakicë e produkteve të ndryshme, përmes një demonstruesi ose një personi i shitjeve (derë më derë)	Mbyllen
101	Shërbime ushqimi dhe pije (me përjashtim të atyre shërbim catering/delivery)	Mbyllen
126	Arsimimi	Mbyllen
130	Aktivitete krijuese, arte, dhe aktivitete çlodhëse	Mbyllen
131	Bibliotekat, arkivat, muzeumet dhe të tjera aktivitete kulturore	Mbyllen
132	Aktivitete të lojërave të fatit dhe basteve	Mbyllen
133	Aktivitete sportive, argëtuese dhe çlodhëse.	Mbyllen
136	Aktivitete të tjera shërbimi (Trajtime Estetike, mirëqenie fizike, palestra)	Mbyllen



PLANI FINANCIAR

Në datën 19 mars 2020, qeveria prezantoi Planin Financiar në kuadër të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19. Disa nga masat e prezantuara më poshtë hynë në fuqi me Aktin Normativ Nr.6, datë 21.3.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 88/2019, për buxhetin e vitit 2020. [Akti Normativ Nr. 6 datë 21.03.2020](#)

- Strukturave të Ministrisë së Shëndetësisë i alokohen 2.5 miliardë lekë, me qëllim pajisjen e institucioneve dhe personelit me materiale mjekësore ose mbështetjen e stafëve mjekësore.
- Në funksion të shoqërive tregtare, të cilat objektivisht kanë paaftësi paguese të pagave të punonjësve, vendoset një fond prej 10 miliardë lekë, përmes instrumentit të një garancie sovranë për kredi marrje.
- Vendosja e 6.5 miliardë lekë në kuadër të përmbushjes së nevojave më urgjente të shtresave së mëposhtme:
 - Biznesi i vogël;
 - Shtresat në nevojë;
 - Papunësia e mundshme si pasojë e situatës aktuale.
- Ministrisë së Mbrojtjes i vihen në dispozicion 2 miliardë lekë në funksion në Operacionit Humanitar.
- Krijimi i një fondi rezervë prej 1 miliardë lekë, në dispozicion të Këshillit të Ministrave si përgjigje ndaj çdo nevoje urgjente që mund të lind përgjatë situatës aktuale.
- Kamatëvonesat për debitorët aktivë (familjarë apo biznes i vogël) të cilët aktualisht kanë konsum energjie do të fshihen, me efekt financiar deri në 15 miliardë lekë.
- Riskedulimi në 6 mujorin e dytë të vitit 2020, dhe në vazhdim, i tatim fitimit për biznesin i cili përket në fashën 2 - 14 milionë lekë xhiro.
- Afati i dorëzimit të bilanceve online apo drejtë për drejtë në Qendrën Kombëtare të Biznesit (p.sh. QKB) nga bizneset përkatëse, shtyhet deri në 1 qershor 2020.